



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK177/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 121/10

Parashtrues

**Sitaram Chaulagai,
Krishna Bandur Chamlagai,
Chandra Kala Chauhan, dhe
Hom Bahadur Battarai**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Lartë për
Kundërvajtje në Prishtinë GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010,
1261/2010, të 22 nëntorit 2010.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: (1) Sitaram Chaulagai, (2) Krishna Bandur Chamlagai, (3) Chandra Kala Chauhan, dhe (4) Hom Bahadur, të përfaqësuar nga z. Linn Slattengren, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar gjyqësor

2. Parashtruesit i kontestojnë vendimet e Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, dhe 1261/2010, të 22 nëntorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit pohojnë se të gjitha vendimet përkatëse gjyqësore tregojnë se ata janë diskriminuar në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe se kurrë nuk u ishte ofruar mundësia ta provonin gjendjen faktike para organeve përkatëse, gjë që përbën shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
4. Ata më tej ankohen që *“Gjykata e Lartë për Kundërvajtje dhe Gjykata Komunale për Kundërvajtje nuk e kanë marrë parasysh faktin që ishte parashtruar ankesë administrative në nivel administrativ kundër vendimit të nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm i MPB-së, në bazë të të cilit ishte lëshuar Urdhër Largimi i Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj, as që i kishin marrë parasysh faktet, provat apo argumentet që provojnë të kundërtën e asaj që ishte thënë në vendimet e Komisionit për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm të MPB-së dhe të Gjykatës”*.
5. Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të caktojë masë të përkohshme, me të cilin do ta shtynte urdhër largimin, për arsye se largimi do t'u shkaktonte dëme materiale në vlerë prej 30.000 eurove, dhe se kjo do ta shqetësonte emocionalisht njërin prej parashtruesve, znj. Chandra Kala Chauhan, duke pasur parasysh faktin që ajo ishte shtatzënë. Ajo pohon që shëndeti i saj dhe shëndeti i fetusit të saj do të viheshin në rrezik.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 3 dhjetor 2010.
8. Më 7 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 121/10, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 121/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.
9. Më 13 dhjetor 2010, Gjykata e miratoi kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme deri sa Gjykata të vendoste lidhur me këtë kërkesë.
10. Më 11 janar 2011, Gjykata Kushtetuese mori përgjigje nga Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, të cilës kërkesa i ishte komunikuar për komente. Gjykata e Lartë theksoi se kërkesa përmbante një sërë të metash, qoftë procedurale apo substanciale.
11. Më 12 janar 2011, Gjykata kërkoi sqarim nga Komisioni për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm lidhur me vendimin e vet përfundimtar.

12. Më 24 janar 2011, Gjykata mori një sqarim nga Komisioni për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm, në të cilin sqarohej se më 11 nëntor 2010, parashtruesit ushtruan ankesë kundër vendimit të Komisionit, dhe se më 30 nëntor 2010, Komisioni për Ankesa vendosi lidhur me ankesën e parashtruesve në përputhje me nenin 46 (1), pika 1.3, të Ligjit Nr. 03/L-126, me ç'rast e hodhi poshtë ankesën. Në vendimin e 30 nëntorit 2010, parashtruesit u njoftuan se kishin 30 ditë në dispozicion për të filluar ankesë administrative në Gjykatën Supreme.

13. Më 24 maj 2011, Gjykata kërkoi sqarim shtesë nga parashtruesit lidhur me këto çështje:

(1) Nëse, në përputhje me nenin 241-246 të Ligjit për Kundërvajtje, ata kanë ushtruar ankesë kundër Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, dhe 1261/2010, të 22 nëntorit 2010;

(2) Nëse, në përputhje me nenin 228-233 të të njëjtit Ligj, ata kanë kërkuar përsëritje të procedurës;

(3) Nëse përgjigja do të ishte pozitive për cilëndo pyetje, nëse i kanë dorëzuar detajet lidhur me atë;

(4) Nëse përgjigja në këto pyetje do të ishte negative, nëse mund t'i sqarojnë arsyet për atë;

(5) Nëse kanë parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme kundër Vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të të Huajve Nr. 1361, të 1 dhjetorit 2010, nëse jo, t'i sqarojnë arsyet për atë.

14. Më 1 qershor 2011, parashtruesit u përgjigjën duke thënë:

“[...]

(1) Kemi ushtruar ankesë kundër vendimeve të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, e cila i refuzoi ankesat tona dhe i vërtetoi vendimet e gjykatës së shkallës së parë. Kjo i shteroi të drejtat tona për ankesë sipas ligjit. Pas një analize të kujdesshme juridike, menduam që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilën e kishim parashtruar, ishte e papranueshme. Për këtë arsye nuk ushtruam kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

(2) Nuk kemi parashtruar asnjë propozim në gjykatën kompetente për përsëritje të procedurës. Duke u bazuar në sfondin dhe rrethanat faktike të çështjes, menduam që përdorimi i këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik nuk ishte i pranueshëm.

(3) Me respekt tregojmë që kurrë nuk kemi marrë vendim nga organi administrativ i shkallës së dytë, që shërben si kolegji i apelit. Kemi parashtruar ankesë kundër vendimeve të Komisionit për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm, që vepron si organ administrativ i shkallës së parë, Komisionit të Ankesave për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm të të Huajve, që vepron si kolegji administrativ për apele, por asnjë vendim lidhur me këtë ankesë nuk na është dorëzuar neve apo ankuesve.

[...]”

15. Më 10 qershor 2011, Gjykata kërkoi sqarim shtesë nga Komisioni për Shqyrtim, Komisioni për Ankesa, DMH-ja, Gjykata Komunale për Kundërvajtje dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje lidhur me çështjet në vijim:

Nga DMH-ja

- (1) *A u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës urdhër largimi në gjuhën që e kuptojnë? Nëse jo, cila është arsyeja?*
- (2) *A kanë qenë parashtruesit e kërkesës të informuar për mjetet juridike kundër urdhër largimit?*
16. Më 14 qershor 2011, DMH-ja ia dërgoi Gjykatës urdhër largimin që u ishte lëshuar parashtruesve dhe u ishte dërguar parashtruesve në gjuhën angleze dhe shqipe bashkë me këshillën juridike se parashtruesit kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër urdhër largimit brenda tetë ditëve, por që ankesa nuk e pezullon përmbarimin e urdhër largimit. Përveç kësaj, DMH-ja tha që parashtruesit ishin njoftuar gojarisht, por në praninë e avokatit, z. Bardhë Ademaj, ata refuzuan ta pranonin urdhër largimin.

Nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje

- (1) *A u ishte dorëzuar parashtruesve aktgjykimi i Gjykatës në gjuhën që e kuptojnë?*
17. Më 22 qershor 2011, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje u përgjigj duke thënë se aktgjykimi i Gjykatës u ishte dërguar parashtruesve në gjuhën angleze në pajtim me nenin 17 të Ligjit (Nr. 02/L-37) për përdorimin e gjuhëve.

Nga Komisioni për Shqyrtim

- (1) *A kanë qenë parashtruesit e kërkesës të ftuar në seancën e Komisionit për Shqyrtim, ku provat e parashtruara nga zyrtarët e DMH-së janë diskutuar?*
- (2) *A u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës vendimi i Komisionit për Shqyrtim në gjuhën që e kuptojnë? Nëse jo, për cilat arsye?*
18. Më 24 gusht 2011, Komisioni për Shqyrtim u përgjigj duke thënë që:

“[...]

- (1) *Komisioni për Shqyrtim nuk i ka ftuar parashtruesit e kërkesës në seancë pasi nuk e ka parë të arsyeshme. Anulimi i leje qëndrimit është bërë në bazë të raportit policor, që i ishte prezantuar Komisionit për Shqyrtim dhe i cili konfirmoi se parashtruesit e kërkesës i kanë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për të Huaj.*
- (2) *Vendimi i marrë nga Komisioni për Shqyrtim u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës në gjuhën shqipe pasi kërkesën për leje qëndrim të përkohshëm e kanë parashtruar në gjuhën shqipe.*

[...]”

Nga Komisioni për Ankesa

- (1) *Të dorëzoni procesverbalin e seancës së Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të të Huajve, të marrë në seancën e Komisionit, në përputhje me nenin 18 [Procesverbali i*

takimit], paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2010 – të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- (2) A u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës vendimi i Komisionit në gjuhën që e kuptojnë? Nëse jo, për cilat arsye?
- (3) A kanë qenë parashtruesit e kërkesës të vetëdijshëm për mundësinë e inicimit të një procedure gjyqësore në Gjykatën Supreme, në qoftë se vendimi i Komisionit për Ankesa nuk u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës në gjuhën që e kuptojnë?
- (4) Të dorëzoni një kopje të fletë dërgesës që dëshmon se Vendimi u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës.

19. Komisioni për Ankesa u përgjigj më 24 gusht duke thënë që:

“[...]

- (1) Vendimi i marrë nga Komisioni për Ankesa u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës në gjuhën shqipe pasi nuk është i obliguar ta bëjë një gjë të tillë dhe pasi avokati i tyre e ka dorëzuar ankesën në gjuhën shqipe dhe gjuha amtare e drejtorit të kompanisë Interex Associates, z. Bejtush Isufi, është gjuha shqipe.
- (2) Sipas informatave të dhëna nga zyrtarët e DMH-së, ky vendim i është vënë në dispozicion avokatit të parashtruesve, të cilët kishin refuzuar ta pranonin atë.

...”

20. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

21. Parashtruesi i parë i kërkesës, Sitaram Chaulagai, shtetas i Nepalit, erdhi në Kosovë në tetor të vitit 2009 dhe themeloi një biznes, restorantin “Good Morning Global Group”, në Prishtinë. Me sa duket, ai e mori lejen e nevojshme, dhe më pas, në fillim të vitit 2010, atij iu bashkëngjitën edhe tre parashtruesit e tjerë të kërkesës, të cilëve Ministria e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: MPB) ua lëshoi letërnjoftimet për të huaj dhe leje qëndrimin e përkohshëm, të vlefshëm deri më 23 tetor 2010. Ata gjithashtu morën leje për punë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila do të skadonte më 21 tetor 2010, për të punuar në restorant.
22. Restoranti “Good Morning Global” hapi edhe një degë, me sa duket të regjistruar nën emrin “Mount Everest Restaurant”. Megjithatë, kjo degë ishte mbyllur për shkaqe financiare dhe ishte hapur dega tjetër, “Bollywood Restaturant”, ku parashtruesit e kërkesës filluan të punonin.
23. Më 4, 5 dhe 6 tetor 2010, inspektorët e Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj të MPB-së kryen inspektime në adresat e restoranteve “Good Morning Global” dhe “Bollywood Restaturant”. Zyrtarët e MPB-së gjithashtu kontaktuan me Inspektoratin Tatimor të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe kërkuan informata për statusin e “Bollywood Restaturant”. Sipas raportit të dorëzuar nga Inspektorati Tatimor, “Bollywood Restaturant”, sipas informatave të tij, kurrë nuk kishte pasur qarkullim.
24. Më 5 tetor 2010, tre prej parashtruesve të kërkesës kërkuan të shkonin në DMH, e cila ua kishte konfiskuar lejet e tyre të punës dhe të qëndrimit, si dhe pasaportat e tyre. Më 6 tetor 2010, e njëjta i ndodhi edhe parashtruesit të katërt të kërkesës.

25. Më 9 tetor 2010, DMH-ja parashtrroi kërkesë në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë për të iniciuar procedurë kundërvajtëse kundër parashtruesve të kërkesës.
26. Më 26 tetor 2010, Komisioni për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm i MPB-së nxori vendime me të cilat parashtruesve të kërkesës ua ndërpreu lejen për qëndrim të përkohshëm, me arsyetimin se, në bazë të raportit të inspektimit të DMH-së të 4, 5 dhe 6 tetorit 2010, biznesi në bazë të të cilit ishin lëshuar lejet për qëndrim të përkohshëm, më nuk ekziston. Përveç kësaj, Komisioni për Shqyrtim e udhëzoi DMH-në të nxjerrë urdhra largimi në bazë të nenit 58 [Ekzekutimi i Deportimit] të Ligjit për të Huajt.
27. Më 1 nëntor 2010, vendimi i Komisionit për Shqyrtim iu dërgua parashtruesve të kërkesës, të cilët parashtruan ankesë në Komisionin për Ankesa të Komisionit për Shqyrtim më 11 nëntor 2010.
28. Më 1 nëntor 2010, DMH ua lëshoi parashtruesve të kërkesës urdhër largimet, të cilët me sa duket nuk i pranuan për shkak se ishin vetëm në gjuhën shqipe (Shënim: DMH-ja ia dërgoi Gjykatës kopjet e urdhër largimeve në gjuhën angleze me informatën në vijim të shkruar në urdhra: "Personi u njoftua gojarisht dhe refuzoi ta pranonte urdhrin për largim në prani të avokatit").
29. Zyrtarët e DMH-së i udhëzuan parashtruesit e kërkesës të jenë të pranishëm në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë më 9 nëntor 2010.
30. Më 8 nëntor 2010, DMH-ja i njoftoi parashtruesit e kërkesës se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kishte nxjerrë një vendim me të cilin u ndërpriteshin lejet e tyre të punës. Me sa duket, asnjë vendim i tillë nuk u është dërguar parashtruesve të kërkesës, gjë që do t'u mundësonte ta kontestonin atë vendim.
31. Më 9 nëntor 2010, parashtruesit e kërkesës u paraqitën në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë dhe kërkuan nga Gjykata që ta hidhte poshtë iniciimin e procedurës si të papranueshëm për shkak se ishte e parakohshme, pasi ankesat e tyre kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtim ende ishin duke u shqyrtuar në Komisionin për Ankesa. Megjithatë, Gjykata për Kundërvajtje i shpalli parashtruesit e kërkesës fajtorë për qëndrim në Kosovë për shkak se leja e tyre e qëndrimit kishte skaduar më 26 tetor 2010, e gjobiti secilin prej tyre me nga 100 euro dhe urdhëroi deportimin e tyre të menjëhershëm nga territori i Kosovës pa të drejtë ri-hyrjeje për një periudhë prej dy vjetësh në përputhje me nenin 58 të Ligjit për të huajt. Sipas nenit 55 (3) të Ligjit, ankesa kundër vendimit mbi caktimin e afatit për lëshimin e shtetit nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit. Parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë kundër këtyre vendimeve në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje.
32. Më 22 nëntor 2010, Gjykate e Lartë për Kundërvajtje i refuzoi ankesat e parashtruesve të kërkesës si të pabazuara. Gjykate e Lartë tha se i kishte vlerësuar thëniet e parashtruara në ankesa, vendimet e goditura dhe deklaratimet e parashtruesve të kërkesës të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë, më 9 nëntor 2010, në të cilën pjesërisht pranuan se kanë kryer veprë kundërvajtëse, por thanë se nuk pranuan ta nënshkruanin vendimin për largim, të lëshuar nga DMH-ja, sepse nuk e kuptuan pse ishte lëshuar dhe se nuk kishin vepruar në bazë të tij. Gjykata e Lartë më tej gjithashtu arsyetoi, duke u bazuar në faktet në shkresat e lëndës, se gjendja faktike është vërtetuar pa dyshim si në dispozitiv të vendimit të ankimuar të Gjykatës Komunale, andaj ankesat e parashtruara janë refuzuar si të pabazuara, dhe vendimet e goditura janë vërtetuar si të drejta dhe të bazuara në ligj.

33. Gjykata e Lartë vlerësoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Ajo konstatoi se dënimi që u ishte shqiptuar parashtruesve të kërkesës dhe shqiptimi i masës mbrojtëse ishin përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, prandaj nuk kishte bazë ligjore për abrogimin e vendimeve të goditura apo hedhjen poshtë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, siç u propozua nga parashtruesit e kërkesës, përkatësisht të vendimit për dëbim të detyruar dhe të menjëhershëm nga territori i Republikës së Kosovës. Gjykata e Lartë gjithashtu i njoftoi parashtruesit e kërkesës se kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.
34. Më 30 nëntor 2010, pas dëgjimit të parashtruesve të kërkesës, Komisioni për Ankesa, gjatë shqyrtimit të ankesave të tyre kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtim të 26 tetorit 2010, i refuzoi ankesat e tyre duke thënë se Komisioni për Shqyrtim kishte shqiptuar vendime të drejta duke u bazuar në procedurën e paraparë ligjore, sepse parashtruesit e kërkesës nuk kishin vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për të huajt dhe Udhëzimet Administrative për zbatimin e atij Ligji. Prandaj, Komisioni për Ankesa vendosi njëzëri sipas nenit 46 (1) (3) të Ligjit për të huajt, i cili përcakton që organi kompetent i ndërpret qëndrimin një të huaji në Kosovë [...] të cilit i është lejuar qëndrimi i përkohshëm, [...], nëse ai/ajo qëndron në Kosovë në kundërshtim me qëllimin për çka i është dhënë leja e përkohshme. Prandaj, Komisioni për Ankesa e mbështeti vendimin e Komisionit për Shqyrtim me të cilin refuzohej leja për qëndrim të përkohshëm në Kosovë. Në vendim më tej thuhej që parashtruesit e kërkesës mund të fillojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Supreme brenda 30 ditësh nga pranimi i këtij vendimi.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

35. Parashtruesit e kërkesës pohojnë që Komisioni për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm gabimisht ka bërë inspektimin në adresën e degës-njësies së shuar, dhe se biznesi i tyre ekziston edhe sot, dhe kjo mund të vërtetohet shumë thjesht, duke vizituar lokalitetin e tyre.
36. Ata më tej pohojnë se kur iu prezantua urdhër largimi, ata qenë të detyruar ta angazhonin një avokat për të kuptuar se çfarë do të nënshkruanin. Më pas, së bashku me avokatin e tyre, ata shkuan në DMH, ku avokati i tyre kërkoi t'u jepej urdhri për largim, por zyrtarët e DMH-së refuzuan t'ua japin atë duke thënë që pasi parashtruesit e kërkesës fillimisht kishin refuzuar ta pranonin atë dokument, DMH-ja nuk mund t'ia jepte tani dokumentet përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës. Sipas avokatit të tyre, parashtruesve të kërkesës kurrë nuk u është komunikuar urdhri për largim, prandaj nuk kanë pasur mundësi të ankohen. Në vend të kësaj, zyrtarët e DMH-së i udhëzuan parashtruesit e kërkesës të paraqiten në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje.
37. Parashtruesit e kërkesës më tej pohojnë se është e qartë që asnjëri prej kritereve të përmendura në nenin 79 [Mbajtja e Dokumentit], paragrafin 1, të Ligjit për të huajt, nuk ishte përmbushur dhe që, si rrjedhojë, konfiskimi i dokumenteve të tyre të identifikimit nuk kishte bazë ligjore.
38. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pohojnë se urdhër largimi është akt administrativ i lëshuar nga organet administrative të shkallës së parë në bazë të nenit 128 të Ligjit për Procedurën Administrative; prandaj Komisioni për Ankesa, në kuadër të MPB-së, nuk e ka marrë parasysh faktin që, gjatë ushtrimit të mjetit juridik, përmbartimi i aktit administrativ është dashur të pezullohej. Përveç kësaj, ata gjithashtu pohojnë se sipas nenit 128 (2) (a), (b), (c) dhe (d) të atij Ligji, organet administrative nuk kishin dorëzuar asnjë provë në bazë të të cilës do të mund të ndalohej ushtrimi i procedurës ankimore kundër organeve kompetente administrative. Sipas mendimit të tyre, neni 128 (3) e

obligon organin administrativ që ta informojë palën lidhur me arsyet për mospezullimin e aktit administrativ, gjë që ai organ nuk e kishte bërë.

39. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës ankohen që Gjykata Komunale për Kundërvajtje nuk e kishte marrë parasysh faktin se ishte ushtruar ankesë administrative kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtim për t'i shqyrtuar ankesat në bazë të të cilit DMH-ja kishte nxjerrë urdhrin për largim.
40. Për më tepër, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje dhe Gjykata Komunale për Kundërvajtje nuk e kanë marrë parasysh faktin se ishte ushtruar ankesë administrative në nivelin administrativ kundër vendimit të nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm i MPB-së, në bazë të të cilit Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e kishte nxjerrë urdhrin për largim, e as që i kishin marrë parasysh faktet, provat apo argumentet që do ta provonin të kundërtën e asaj që ishte thënë në vendimin e Komisionit për Shqyrtim dhe të Gjykatës.
41. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pohojnë që parashtruesit e tyre nuk ishin marrë parasysh sepse janë saktësisht e kundërta e asaj që ishte thënë në vendimin e Komisionit për Shqyrtim dhe të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje.
42. Znj. Chandra Kala Chauhan, që ishte shtatzënë në kohën e dorëzimit të kërkesës, pohon që mjeku i saj i ka rekomanduar të pushonte, por nuk i ka rekomanduar regjim shtrati, që do të thotë se ajo mund të lëvizë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjykata vëren që parashtruesit e kërkesës ankohen për dy çështje:
 1. Për procedurat administrative në Komisionin për Shqyrtim dhe në Komisionin për Ankesa; dhe
 2. Për procedurat në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje dhe në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje.
44. Në këtë drejtim, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
45. Këto kritere janë para së gjithash: ngritja e çështjes para Gjykatës në mënyrë ligjore (neni 113 (1) i Kushtetutës), shterimi i të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj (neni 113 (7) i Kushtetutës); parashtrimi i kërkesës brenda afatit të caktuar (nenet 49 dhe 56 të Ligjit); qartësimi se cilat të drejta dhe liri janë shkelur, duke treguar cili akt (cilat akte) konkrete të autoritetit publik kontestohet (kontestohen) (neni 48 i Ligjit), kërkesat duhet të jenë të arsyetuara dhe atyre duhet t'u bashkëngjiten provat e nevojshme (neni 22 i Ligjit), duke përfshirë elemente të tjera të informatave.

1. Lidhur me procedurat administrative

46. Për të gjykuar për ankesën e parashtruesve lidhur me procedurat administrative në Komisionin për Shqyrtim dhe në Komisionin për Ankesa, dhe për pretendimin e tyre se u është mohuar e drejta për mjete juridike, siç garantohet me nenin 32 të Kushtetutës, Gjykata mendon se është e nevojshme së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.
47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

48. Kjo do të thotë se, sa u përket procedurave administrative në Komisionin për Shqyrtim dhe në Komisionin për Ankesa, parashtruesit e kërkesës është dashur t'i kenë treguar kësaj Gjykate se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, duke përfshirë ankesën në Dhomën Administrative të Gjykatës Supreme.
49. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që Vendimi i Komisionit për Ankesa (Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për të Huajt), i 30 nëntorit 2010, përmban informata për mjetet juridike kundër vendimit të vet, dhe në të thuhet: *"Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të tij, mund të fillojë konfliktin administrativ në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës"*.
50. Në pyetjen e parashtruar nga kjo Gjykatë pse parashtruesit e kërkesës nuk e kanë shfrytëzuar këtë mjet juridik, avokati i tyre u përgjigj se asnjë vendim për këtë ankesë nuk i ishte dorëzuar as atij as parashtruesve të kërkesës.
51. Megjithatë, kur kjo Gjykatë e pyeti Komisionin për Ankesa *"Nëse Vendimi i Komisionit për Ankesa u është dërguar parashtruesve të kërkesës në gjuhën që e kuptojnë dhe, nëse jo, për cilat arsye?"*, Komisioni për Ankesa u përgjigj se *"Vendimi u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës në gjuhën shqipe pasi Komisioni për Ankesa nuk është i obliguar ta bëjë përkthimin e vendimeve dhe pasi avokati i tyre e ka dorëzuar ankesën në gjuhën shqipe dhe gjuha amtare e drejtorit të kompanisë ligjore është gjuha shqipe"*. Komisioni më tej përmendi që *"më 3 dhjetor 2010, vendimi i parë i ishte dërguar DMH-së. Sipas informatave të ofruara nga zyrtari i DMH-së, ky vendim ishte vënë në dispozicion të përfaqësuesit ligjor të të pandehurit [...], i cili refuzoi ta pranonte vendimin. Kopje të vendimit janë vendosur në arkivin e Sektorit për të Huajt [...]"*.
52. Në këto rrethana, Gjykata duhet të arrijë në përfundim se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre se nuk ishin fare në dijeni për rezultatin e procedurave në Komisionin për Ankesa apo që nuk kishin qasje në tekstin e vendimit të tij. Prandaj, rezulton që ata nuk kanë vepruar në pajtim me rregullin e shterimit të mjeteve juridike, qëllimi themelor i të cilit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 27 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

2. Lidhur me procedurat në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje dhe në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje

53. Lidhur me ankesën se vendimet e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje dhe të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje i kanë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me:
 - a. Nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, pasi Gjykata u mor vetëm me çështje teknike dhe i shpalli fajtorë për moszbatim të urdhrit për dëbim, kurse fare nuk e shqyrtoi "mënyrën arbitrare të nxjerrjes së atij vendimi"; dhe

- b. Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, pasi parashtruesve të kërkesës gjoja u është mohuar e drejta për mjete juridike në nivel administrativ dhe nuk patën mundësi t'i dëshmonin Komisionit se vlerësimi i gjendjes faktike ishte bërë në mënyrë plotësisht të gabuar, gjë që shpuri në revokim të lejes për qëndrim dhe nxjerrje të urdhrit për dëbim.

Gjykata është e mendimit se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt me rastin e shqyrtimit të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

54. Kjo Gjykatë mund të shqyrtojë vetëm nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë përkatëse dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të duhur ashtu që parashtruesit e kësaj kërkesë të kenë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
55. Në këtë rast, parashtruesit e kërkesës thjesht kontestojnë nëse Gjykata Komunale për Kundërvajtje dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje e kanë zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin në fuqi dhe nuk pajtohen me gjetjet faktike të gjykatës në lidhje me rastet e tyre.
56. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata, si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
57. Duke marrë parasysh tërë këtë që u tha më lart, rezulton që kërkesa, si tërësi, duhet të refuzohet si qartazi e pabazë.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

58. Sa i përket kërkesës së parashtruesve për masë të përkohshme, që Gjykata e miratoi më 13 dhjetor 2010, "derisa të vendoste lidhur me këtë kërkesë", Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, në veçanti, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë që në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjdhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Megjithatë, duke pasur parasysh që kërkesa është shpallur e papranueshme, masa e përkohshme e caktuar nga kjo Gjykatë tani ka skaduar sipas rregullit 56 (9) të Rregullores së punës për të kërkuar masë të përkohshme

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullave 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 23 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TË DEKLAROJË që masa e përkohshme ka skaduar;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit;

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr. Iliriana Islami



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani